



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2022:053579
Datë: 05.02.2024
Numri i dokumentit: 05284829

PA1.nr.1663/23

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti i Pergjithshem, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Mehmet Ndrecaj, kryetar i kolegjit, Abdullah Ahmeti dhe Ferit Osmani, anëtarë, me praktikantin gjyqesor Arben Arifi, si procesmbajtës në lëndën penale ndaj të akuzuarit E.H., nga fshati ...– Komuna e Mitrovices, për shkak të veprës penale, Shantazhi nga neni 329 paragrafi 1 të KPRK-se, për të vendosur sipas ankesës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, ankesës së të dëmtuarit B.H. dhe ankesës së mbrojtësit të akuzuarit, të ushtruara kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë P.nr.212/2023 të datës 06.11.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 02 Shkurt 2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohen si të pabazuara ankesa e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, ankesës së të dëmtuarit B.H. dhe ankesa e mbrojtësit të akuzuarit E.H., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë P.nr.212/2023 i datës 06.11.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë P.nr.212/2023 të datës 06.11.2023, i akuzuari E.H., është shpallur fajtor për shkak të veprës penale, Shantazhi nga neni 329 paragrafi 1 të KPRK-se, për të cilën i është shqiptuar dënimi me burgim në kohezgjatje prej 8 (tete) muaj me kusht që i njëjti dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në afat prej 2 (dy) viteve pas plotfuqishmerisë së këtij aktgjykimi nuk kryen tjetër veprë penale si dhe dënim me gjobe në shumë prej 1000 (njëmijë) euro, e të cilën gjobe është i obliguar që ta paguajë pas plotfuqishmerisë së këtij aktgjykimi. Në qoftë se i akuzuari

nuk e paguan denimin me gjobe i njejt do te i zevendesohet ne denim me burgim, ku per qdo 20 euro te gjobes do te i llogaritet nje dite burgu.

I akuzuari eshte obliguar qe te paguaje shpenzimet e procedures penale qe dalin sipas llogarise perfundimtare te gjykates, ne emer te paushallit gjyqesor shumen prej 20 (njezet) euro, si dhe per fondin e kompensimin e viktimave te krimit shumen prej 20 (njezet) euro, e te gjitha keto ne afat prej 15 ditesh pas plotfuqishmerise se aktgjykimit.

Pala e demtuar B.H., ka hekur dore nga kerkesa pasurore juridike.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesa kane ushtruar :

Prokuroria Themelore ne Mitrovice, per shkak të vendimit mbi sanksionin penal, duke propozuar qe aktgjykimi i ankimuar i gjykates se shkalles se pare te ndryshohet, dhe te akuzuarit per vepren penale per te cilen eshte shpallur fajtor te i shqiptohet dënim me i larte se se sa denimi i shqiptuar nga ana e gjykates se shkalles se pare, e me te cilin dënim do te arrihej qëllimi i dënimit i parapare me nenin 38 te KPRK-se.

I demtuari B.H., nga Mitrovica, per shkak të vendimit mbi sanksionin penal, duke propozuar qe aktgjykimi i ankimuar i gjykates se shkalles se pare te ndryshohet, dhe te akuzuarit per vepren penale per te cilen eshte shpallur fajtor te i shqiptohet dënim me i ulet me burgim te kushtezuar dhe me gjobe e me te cilen do te arrihej qëllimi i denimit i parapare me nenin 38 te KPRK-se.

Mbrojttesi i te akuzuarit E.H. – Av.Bajram Halimi, per shkak të vendimit mbi sanksionin penal, duke propozuar qe aktgjykimi i ankimuar i gjykates se shkalles se pare te ndryshohet, dhe te akuzuarit per vepren penale per te cilen eshte shpallur fajtor te i shqiptohet dënim me i ulet me burgim te kushtezuar dhe periudhe verifikuese me e ulet si dhe denim minimal me gjobe, e me te cilin dënim do te arrihej qëllimi i dënimit i parapare me nenin 38 te KPRK-se.

Prokurori i Apelit i Kosovës, duke u skjaruar përkitazi me ankesen e Prokurorise Themelore ne Mitrovice, ankeses se te demtuarit B.H. dhe ankeses se mbrojtetit te akuzuarit E.H., me shkresën e vet PPA.II.nr.1695/2023 të datës 29.12.2023 ka propozuar që Gjykata e Apelit e Kosovës, ankesen e Prokurorise Themelore ne Mitrovice ta aprovoje si te bazuar, ndersa ankesa e mbrojtetit te akuzuarit E.H., si dhe ankesa e te demtuarit B.H., te refuzohen si te pabazuara, ndersa aktgjykimi i ankimuar i Gjykates se shkalles se pare te ndryshohet dhe te akuzuarit te i shqiptohet denim me i larte se sa denimi i shqiptuar nga ana e gjykates se shkalles se pare.

Gjykata e Apelit mbajti seancen e kolegjit ne pajtim me nenin 390 paragrafi 1 te KPPRK-se, per te cilen nuk i ftoi palet ngase ne rastin konkret kemi te bejme me denim me burgim te kushtezuar dhe denim me gjobe dhe pretendimet ankimore jane vetem lidhur me sanksionin penal andaj prezenca e paleve nuk eshte e obliguar.

Kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës, konform nenit 394 par.1 të KPPK-së i shqyrtoi shkresat e lëndës, vlerësoi aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore te Prokurorise Themelore ne Mitrovice, ato te pales se demtuar dhe mbrojtetit se te akuzuarit, dhe gjeti se:

- Ankesat nuk jane te bazuara.

Edhe pse aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk ankimohet për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, megjithatë Gjykata e Apelit e Kosovës të njejtin e shqyrtoi në këtë aspekt sipas detyrës zyrtare konform nenit 394 të KPPRK-së dhe konstatoi se nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, e as shkelje të ligjit penal e të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e tij.

As gjendja faktike nuk ka qenë objekt shqyrtimi ngase i akuzuari gjatë shqyrtimit fillestar të datës 30.10.2023 në bazë të nenit 242 të KPRK-së ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar, i cili pranim është bërë në mënyrë vullnetare nga i akuzuari, pas konsultimit të mjaftueshem me mbrojtësin e tij. Pranimi i fajësisë ka mbështetje në faktet që përmban aktakuza dhe provat që gjenden në shkresat e lëndës. Nga një gjendje e tillë e vërtetuar faktike del që në rastin konkret drejtë është aplikuar edhe ligji penal.

Sa i perket vendimit mbi sanksionin penal Prokuroria Themelore ne Mitrovice, me ankesë pretendon se Gjykata e shkallës së parë me rastin e shqiptimit të denimit me burgim të kushtëzuar si dhe denim me gjobe, i ka mbivlerësuar rrethanat lehtësuese si pranimin e fajësise për veprën penale të kryer, sjelljen korrekte të pandehurit në gjykatë, kerkimfaljen, faktin se e ka kompensuar të demtuarin si dhe premtimin se në të ardhmen nuk do të kryejë vepra penale tjera, mirepo nuk i ka vlerësuar në mënyrë të duhur rrethanat rënduese si faktin se i akuzuari edhe me parë ka qenë i denuar me aktgjykime të plotefuqishme, e sikur keto rrethana të ishin vlerësuar në mënyrë të duhur është dashur që të akuzuarit të i shqiptojë denim dukshëm me të lartë se sa denimi i shqiptuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë, e i cili do të ishte në proporcion me shkallën e rrezikshmerisë, mënyrën e kryerjes si dhe pasojën e shkaktuar dhe se me denimin e shqiptuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë nuk mund të arrihet qellimi i denimit i parapare me nenin 38 të KPRK-se, andaj ka propozuar që ankesa e Prokurorisë Themelore ne Mitrovice të aprovohet si e bazuar.

I demtuari B.H., sa i perket sanksionit penal, Gjykatës së Apelit i ka propozuar që nga arsyeja se nga kryerja e vepres penale ka kaluar një kohë e gjatë, se i akuzuari është i gjendjes së dobët ekonomike dhe se me të tani kanë raporte shumë të mira dhe korrekte, ka propozuar që të njejtin të i shqiptohet një denim dukshëm me i ulët me burgim të kushtëzuar dhe me gjobe minimale.

Mbrojtësi i të akuzuarit E.H. – Av.Bajram Halimi nga Mitrovica, sa i perket sanksionit penal, me ankesë pretendon se Gjykata e shkallës së parë nuk i ka vlerësuar në mënyrë të duhur rrethanat lehtësuese si pranimin e fajësise nga i akuzuari në shqyrtimin fillestar, pendimin, kerkimfaljen, se i njejtin është i papunë, e ka nënën e semurë në gjendje të rëndë shëndetësore, se e ka kompensuar të demtuarin, e sikur keto rrethana të ishin vlerësuar në mënyrë të duhur të akuzuarit është dashur që të i shqiptohet një denim dukshëm me i ulët me burgim të kushtëzuar dhe periudhë verifikimit me të shkurtër si dhe denim minimal me gjobe, andaj ka propozuar që ankesa e mbrojtësit të aprovohet si e bazuar.

Gjykata e Apelit e Kosoves, vlerësoi pretendimet ankimore lidhur me sanksionin penal të Prokurorisë Themelore ne Mitrovice për shqiptimin e denimit me të lartë si dhe ato të demtuarit dhe mbrojtësit se të akuzuarit për shqiptimin e denimit me të ulët, dhe pas vlerësimit të njejtave, dhe duke i patur parasysh rrethanat e cekura më lartë dhe rrethanat e rastit konkret, Gjykata e Apelit konstaton se Gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë

te plote i ka vlerësuar rrethanat lehtësuese dhe renduese nga neni 69 dhe 70 të KPRK-se të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, andaj konstaton se denimi i shqiptuar me burgim të kushtezuar dhe denimi me gjobe të akuzuarit nga ana e gjykatës së shkallës së parë janë në harmoni me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale të kryer, andaj e refuzoi si të pabazuara ankesën e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, ankesën pa lëndë të demtuar dhe mbrojtësit të akuzuarit, duke e vërtetuar aktgjykimin e Gjykatës së shkallës së parë, e me bindje se me denimin e shqiptuar nga ana e Gjykatës së shkallës së parë, do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 38 të KPRK-së, respektivisht parandalimi i kryerësve nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, të bëhet rehabilitimi i tij, parandalimi i personave tjerë nga kryerja e veprave penale dhe ngritja e moralit për respektimin e ligjit.

Nga arsyet e cekura më lartë, e në bazë të nenit 401 të KPPRK-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PA1.nr.1663/23 më 02.02.2024

Procesmbajtësi
Arben Arifi

Anëtarët e kolegjit
Abdullah Ahmeti

Kryetar i kolegjit
Mehmet Ndrecaj

Ferit Osmani
